Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raport i Auditimit
të Teknologjisë së Informacionit

SISTEMI ELEKTRONIK PËR MENAXHIMIN E STUDENTËVE

Prishtinë, qershor 2026

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji[1] i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000[2] dhe Udhëzuesin për Auditimin e Sistemeve të Informacionit (GUID 5100[3]).

Auditimet e teknologjisë së informacionit të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të fituar siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit[4], ekonomisë[5], dhe efektivitetit[6] të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrolleve përkatëse.

1 Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës
2 SNISA 3000 – Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike.
3 GUID 5100 – Udhëzuesi për auditimin e sistemeve të informacionit lëshuar nga INTOSAI.
4 Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës.
5 Ekonomia –Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë.
6 Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit "Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve" në konsultim me Drejtorin e Departamentit të Auditimit Samir Zymberi, i cili e ka menaxhuar e mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Gazmend Lushtaku, Udhëheqës i ekipit; dhe

Gëzim Krasniqi, Anëtar i ekipit.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria,
Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
http://zka-rks.org

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave

SEMS	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve
UP	Universiteti i Prishtinës
RFID	Radio Frequency Identification (Identifikimi me radiofrekuencë)
QR Code	Quick Response Code (Kodi i përgjigjes së shpejtë)
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SMC	Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
TI	Teknologjia e Informacionit
PVB	Plani për vazhdimësinë e biznesit
PRF	Plani i rimëkëmbjes nga fatkeqësitë
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
SEMS	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve
UP	Universiteti i Prishtinës
DDoS	Distributed Denial-of-Service

Përmbledhje e përgjithshme

Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS) është platforma qendrore dixhitale e Universitetit të Prishtinës (UP), e cila mbështet procese kritike akademike dhe administrative, duke përfshirë regjistrimin e studentëve, menaxhimin e lëndëve dhe notave, pagesat, raportimin institucional dhe lëshimin e diplomave. Sistemi mbulon të gjithë ciklin e studentit dhe përdoret nga rreth 22 mijë përdorues aktivë në nivel universitar.

Përkundër rolit të rëndësishëm që ka në funksionimin e Universitetit të Prishtinës dhe përparimeve të arritura në digjitalizimin e proceseve, auditimi ka identifikuar mangësi të rëndësishme në kontrollet e aplikacionit, kontraktimin, qeverisjen e TI-së dhe vazhdimësinë e biznesit.

Në fushën e qeverisjes së TI-së dhe vazhdimësisë së biznesit, mungojnë politika dhe procedura të formalizuara, plane për menaxhimin e rrezikut, plan i vazhdimësisë së biznesit dhe plan i rikthimit nga fatkeqësia. Në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit në UP janë rreth **19 staf profesional,** megjithatë ende nuk janë mbuluar pozitat kyçe apo janë me ushtrues detyre, mungon një sistem i menaxhimit të tiketave për aktivitetet e tyre, për më tepër zyrtarët e TI-së nuk raportojnë për punët/aktivitetet e tyre. Këto mangësi kufizojnë aftësinë e Universitetit të Prishtinës për të siguruar funksionim të qëndrueshëm, të sigurt dhe efektiv të platformës SEMS dhe kërkojnë ndërmarrjen e masave të strukturuara për forcimin e kontrollit dhe qeverisjes së sistemit.

Gjithashtu mungesa e raportimit të rregullt nga zyrtarët e TI-së kufizon menaxhmentin në vendimmarrjen e bazuar në të dhëna dhe menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore të cilat UP-ja i ka aktualisht.

Në fushën e kontraktimit, është konstatuar se Universiteti i Prishtinës nuk ka pasur në pronësi të plotë Kodin Burimor të SEMS për një periudhë të gjatë. Bashkëpronësia e kodit burimor e vendosur me marrëveshje, 70% për Operatorin ekonomik dhe 30% për Universitetit të Prishtinës ka kufizuar në mënyrë substanciale të drejtat e UP-së mbi Kodin burimor dhe ka ndikuar që UP-ja të humb kontrollin e plotë

mbi Sistemin SEMS, duke krijuar varësi të theksuar nga Operatori Ekonomik, paqartësi në menaxhim me sistemin dhe rrezik për vazhdimësinë e shërbimeve. Për më tepër, kontratat nuk përmbajnë elemente thelbësore si tregues të matshëm të performancës, përcaktim të qartë të përgjegjësive, menaxhim të incidenteve, dispozita për mbrojtjen e të dhënave dhe kërkesa për backup. Janë identifikuar edhe boshllëqe kohore ndërmjet kontratave, gjatë të cilave shërbimet janë ofruar pa mbulim kontraktual.

Poashtu në UP mungon ambienti testues për platformën SEMS. Kjo e rrit më tej ekspozimin ndaj rreziqeve operacionale dhe të sigurisë.

Në aspektin e kontrolleve të aplikacionit, janë evidentuar dobësi që cenojnë integritetin dhe besueshmërinë e të dhënave, përfshirë mungesën e validimeve automatike për mbivendosjen e orareve të profesorëve. Si dobësi tjetër është evidentuar edhe përdorimi jo i plotë i sistemit në Fakultetin e Mjekësisë, si dhe mungesën e digjitalizimit të plotë të pagesave dhe validimeve të të dhënave.

Gjithashtu, janë konstatuar mangësi serioze në menaxhimin e privilegjeve dhe roleve të përdoruesve, përfshirë dhënien e qasjeve pa autorizim formal. Mbivendosje të roleve, përdorimin e llogarive të përbashkëta dhe mungesën e monitorimit sistematik të gjurmëve të auditimit. Këto dobësi rrisin rrezikun e keqpërdorimit, gabimeve në përpunim, pagesave jo të sakta dhe cenimit të parimit të ndarjes së detyrave.

Përgjigja e entiteteve të përfshira në auditim

Universiteti i Prishtinës ka pranuar gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe është zotuar se do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

HYRJE

01

1. Hyrje

Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve-SEMS vepron si sistemi kryesor për mbledhjen dhe menaxhimin sistematik të të dhënave për disa kategori, duke përfshirë: studentët, profesorët, dekanët, administratorët. Sistemi mbështet procese kritike akademike dhe administrative, Në fushën e funksionaliteteve, sistemi mbulon të gjithë "ciklin" e studentit: aplikimin online, regjistrimin semestral, zgjedhjen e lëndëve, fletëparaqitjet dhe provimet, notimin, transkriptën, diplomën dhe shtojcën e saj, kërkesën për titull të diplomës dhe ç'regjistrimet kur është e nevojshme.

SEMS unifikon proceset në një sistem të vetëm, rrit transparencën përmes gjurmimit të plotë të veprimeve, automatizon statistikat dhe vizualizimet, si dhe lidhet në mënyrë të sigurt me sisteme partnere brenda universitetit si: Sistemi për CV akademike, Sistemi e-Votimi, Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Stafit Akademik, Qendrën Studentore, etj. Qëllimi i tij është që të digjitalizoj procese si: verifikimi i pagesave, evidenca e vijueshmërisë, etj. Vijueshmëria evidentohet me RFID(Radio Frequency Identification), QR Code dhe Google Meet.[7]

Përdorues të drejtpërdrejtë janë studentët (Bachelor/Master/PhD, përfshirë studentë ndërkombëtarë në shkëmbim - exchange), profesorët dhe asistentët, organet udhëheqëse (Dekan/Prodekan, Rektorat, Senat), sekretarët dhe zyrtarët e shërbimit studentor, financat në fakultete dhe në nivel qendror, zyrtarët e diplomave/ID-kartelave, auditori i brendshëm dhe administratorët e sistemeve. Çdo rol duhet te operon sipas parimit të privilegjit minimal dhe me gjurmueshmëri të plotë të veprimeve (ruajtjen e logave).

Sipas statistikave të sistemit aktualisht, SEMS ka 4.95 milion fletëparaqitje të regjistruara, 2.5 milion nota të proceduara dhe mbi 980,000 pagesa të regjistruara në sistem

7 Drafti i kontratës - SEMS

Figura 1. Fakultetet dhe numri i studenteve



SEMS vazhdon të krijojë module varësisht nga kërkesat, por ndër modulet kryesore janë: Moduli i Studentit; Moduli i Profesorit; Moduli i Dekanit/Prodekanit; Moduli i pagesave studentore; Moduli i Referentit/Zyrës Studentore; Moduli i Diplomave; Moduli i Financave; Moduli i Auditorit të brendshëm; Moduli i Statistikave; Moduli i Orarit; Moduli i Librarisë/Arkivës; Moduli Tema e diplomës; Moduli për bursat studentore; Moduli i votimit; etj.

SEMS ka filluar zbatimin ne vitin 2012 dhe teknologjitë e përdorura për zhvillimin e SEMS janë: Baza e të dhënave e SEMS është ndërtuar në platformën Microsoft SQL Server 2008, ndërsa ndërfaqja funksionon si aplikacion Win dhe Web, i zhvilluar në Visual Studio.NET(ASP.NET)[8].

8 Kontrata "Mirembajtja e Sistemit Elektronik te Menaxhimit te Puneve me Student" 2012

Figura 2. Faqja kryesore e SEMS-it.



02

OBJEKTIVI I CILJEVI RADA

2. Objektivi dhe fushat e auditimit

Objektivi i këtij auditimi është të vlerësohet menaxhimi dhe administrimi i platformës SEMS dhe nëse platforma siguron mbështetje efektive dhe të sigurt për funksionet kryesore (akademike dhe administrative) të organizatës.

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë rekomandime relevante për UP-në, në mënyrë që të përmirësojnë sistemin e informacionit lidhur me qeverisja e TI-së, kontraktimit dhe kontrollet e aplikacionit.

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit, jemi fokusuar në qeverisjen e TI-së, politikat e kontraktimit, vazhdimësisë se biznesit si dhe kontrollet e aplikacionit duke i përzgjedhur fushat e auditimit si në vijim:

Tabela 1. Fushat dhe çështjet e auditimit

Fushat e auditimit	Çështjet e auditimit
1. Qeverisja e TI	1.1. Politikat dhe procedurat 1.2. Menaxhimi i rrezikut 1.3. Përcaktimi i kërkesave të TI-së
2. Kontraktimi	2.1. Mbajtja e njohurive të biznesit / Pronësia e proceseve të biznesit 2.2. Marrëveshja në Nivel Shërbimi (SLA) 2.3. Siguria
3. Kontrollet e Aplikacionit	3.1. Kontrollet e përpunimit
4. PVB//PRF	4.1. Politikat e Vazhdimësisë së Biznesit

Fushëveprimi i këtij auditimi është Universiteti i Prishtinës, me fokus të veçantë në Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS). Në kuadër të auditimit janë shqyrtuar kontrollet, kontratat, rregulloret dhe planet përkatëse, si dhe standardet e sigurisë së informacionit. Po ashtu, është vlerësuar efikasiteti i proceseve të menaxhimit të të dhënave dhe nëse janë ndërmarrë masa të mjaftueshme për mbrojtjen e të dhënave personale të studentëve dhe integritetin e informacionit akademik.

Ky auditim ka mbuluar periudhën 2022-2025 duke përfshirë gjendjen aktuale të sistemit SEMS dhe përputhshmërinë me praktikat më të mira të qeverisjes së TI-së në arsimin e lartë.

GJETJE DITIMIT

03

3. Gjetjet e auditimit

SEMS ka mundësuar që studentët të aplikojnë online për përzgjedhjen e provimeve, të shohin rezultatet, të shkarkojnë dokumentet e studimeve dhe të komunikojnë me administratën në mënyrë dixhitale. SEMS ka ulur kohën e përpunimit të kërkesave dhe ka përmirësuar transparencën në ofrimin e shërbimeve akademike. Ne gjithashtu kemi bërë një pyetësor me studentët mostër për të kuptuar problemet dhe nevojat e tyre lidhur me SEMS, ku studentët në përgjithësi janë shprehur të kënaqur me përvojat e tyre me SEMS.

Modulet e zhvilluara plotësisht

- Moduli i Studentit
- Moduli i Dekanit/Prodekanit
- Moduli i Referentit
- Moduli i Diplomave
- Moduli i Financave
- Moduli Tema e diplomës
- Moduli për bursat studentore
- Moduli i votimit; etj

Mospërdorimi i plotë i moduleve

Mospërdorimi i plotë i SEMS-it në Fakultetin e Mjekësisë

Modulet që nuk janë zhvilluar plotësisht

- Moduli i pagesave studentore
- Moduli i Profesorit

Krahas zhvillimi qe ka pasur SEMS, janë identifikuar disa mangësi që kërkojnë përmirësim, të cilat janë të paraqitura në këtë kapitull të raportit. Gjetjet e auditimit ndërlidhen me kontrollet e aplikacionit, politikat e kontraktimit, qeverisjen e TI-së dhe planin për vazhdimësinë e biznesit. Gjetjet janë të strukturuara sipas fushave dhe çështjeve të auditimit.

Figura 3. Struktura e çështjeve të auditimit të SEMS



Pjesa e parë e paraqitur në kapitullin 3.1 mbulon çështjet e identifikuara e që kanë nevojë për përmirësim që lidhen me Qeverisjen e TI-së.

Pjesa e dytë që është paraqitur në kapitullin 3.2 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me Kontraktimin.

Pjesa e tretë që është paraqitur në kapitullin 3.3 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me Kontrollet e Aplikacionit.

Pjesa e katër që është paraqitur në kapitullin 3.4 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me planin e vazhdimësisë së biznesit dhe planin e rikthimit nga fatkeqësia.

3.1. Qeverisja e Teknologjisë së Informacionit

Qeverisja e TI-së luan një rol kyç në përcaktimin e mjedisit të kontrollit dhe vendos themelet për krijimin e një praktike të mirë në kontrollin e brendshëm si dhe në raportimin në nivelet funksionale për mbikëqyrjen dhe rishikimin menaxherial[9].

Menaxhimi i rreziqeve të TI-së duhet të jetë pjesë e strategjisë dhe politikave të përgjithshme të organizatës. Menaxhimi i rrezikut përfshin identifikimin e rreziqeve që prekin ekzistencën e aplikacioneve dhe infrastrukturën e TI-së, menaxhimin e vazhdueshëm, përfshirë rishikimin dhe përditësimin vjetor/periodik nga menaxhimi i rreziqeve dhe monitorimin e masave për zvogëlimin e rrezikut[10].

Figura 4. Qeverisja e TI-së



9 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative, Qeverisja e TI
10 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative, Menaxhimi i rrezikut

1. SEMS nuk ka politika dhe plane të përcaktuara për qeverisjen e TI-së dhe menaxhimin e rrezikut si dhe nuk janë mbuluar pozitat e planifikuara për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet në mënyrë efektive.

Organizata dokumenton, aprovon dhe komunikon politikat dhe procedurat e duhura për të udhëzuar operacionet e biznesit dhe të TI-së, me qëllim të arritjes të mandatit të saj. Organizata duhet të ketë politika dhe plane të menaxhimit të rrezikut, si dhe të përcaktoj burimet e mjaftueshme për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet[11].

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në UP nuk ka të dokumentuara, të miratuara dhe të komunikuara politika dhe procedura formale për operacionet e biznesit dhe qeverisjen e TI-së. Po ashtu nuk ka përcaktuar një rol apo mekanizëm të dedikuar për monitorimin e vazhdueshëm të gjurmëve të aktiviteteve të përdorueseve të sistemit. Monitorimi i gjurmëve të aktiviteteve dhe rishikimi i aktiviteteve kryhen vetëm në raste të veçanta, ka ndonjë incident , dhe jo në mënyrë periodike apo të strukturuar.

Mungesa e këtyre politikave dhe procedurave kufizon përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive, standardizimin e proceseve dhe menaxhimin efektiv të rreziqeve, duke rritur rrezikun e ndërprerjes së shërbimeve.

Në rastin e fundit të incidenteve në SEMS, sulmet janë identifikuar vetëm pasi zyrtarët e Departamentit të TI-së kanë vërejtur se sistemi kishte mbingarkesë. Si pasojë e kësaj ngarkese të lartë, sistemi herë pas here binte nga funksioni, dhe vetëm pas ndërhyrjes së operatorit ekonomik që mirëmban dhe zhvillon sistemin është konstatuar se bëhej fjalë për sulme të tipit DDoS. Kjo tregon mungesë të identifikimit paraprak të rreziqeve dhe reagim të vonuar ndaj incidenteve të sigurisë.

Arsyeja e mungesës së politikave të shkruara lidhet me mungesën e njohurive të personave përgjegjës për rëndësinë e këtyre politikave.

Në mungesë të procedurave dhe planeve të dokumentuara, proceset e menaxhimit të sistemeve dhe të dhënave kryhen kryesisht bazuar në përvojën individuale të

11 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative, Qeverisja e TI

stafit aktual dhe operatorit ekonomik. Një qasje e tillë rrit varësinë nga individë të caktuar dhe e bën organizatën të ndjeshme ndaj ndryshimeve në staf apo mungesës së tyre, veçanërisht duke pasur parasysh mungesën e pozitave kyçe si Zyrtari për Siguri Kibernetike dhe Administratori i Databazës.

Si rrjedhojë, në mungesë të procedurave të dokumentuara për backup dhe rikuperim, organizata përballet me rrezik të shtuar për humbje të të dhënave dhe ndërprerje të sistemeve kritike në rast të incidenteve apo fatkeqësive. Universiteti i Prishtinës aktualisht përballet me mungesë të Zyrtarit për Siguri Kibernetike dhe Administratorit të Databazës ndërsa pozita e Drejtorit të Departamentit për TI-në në Administratën Qendrore të UP-së është me ushtrues detyre. Ndërkohë që të punësuar ka 19 zyrtarë të TI-së, prej tyre 3 administratorë të lartë dhe një specialist të TI-së për ID kartela, ndërsa 15 administratorë të TI-së për sisteme janë në nivel të fakulteteve. Megjithatë, këta zyrtarë nuk raportojnë për aktivitetet e tyre të rregullta. Kjo e vështirëson vlerësimin e nivelit të angazhimit dhe performancës së tyre.

Si rrjedhojë, në mungesë të raportimit të rregullt, menaxhmenti nuk posedon informacione të mjaftueshme për të vlerësuar nivelin e angazhimit dhe shfrytëzimit efektiv të burimeve ekzistuese njerëzore. Kjo kufizon mundësinë për të marrë vendime të bazuara në të dhëna lidhur me organizimin dhe shpërndarjen e detyrave, si dhe për të vlerësuar nëse kapacitetet aktuale janë duke u përdorur në mënyrë efikase dhe efektive dhe në përputhje me nevojat prioritare të departamentit të TI-së.

2. Mungesa e planit dhe procesit formal për identifikimin dhe aprovimin e kërkesave të biznesit dhe të TI-së

Organizata duhet të ketë një plan sesi të identifikojë kërkesat e reja të biznesit ose nevojat e TI-së dhe Komiteti Drejtues, i cili aprovon kërkesat, ka informacion të mjaftueshëm për vendimmarrje[12].

12 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative, Qeverisja, Identifikimi, Drejtimi dhe Monitorimi i kërkesave të biznesit

Departamentin e Teknologjisë Informative të Universitetit të Prishtinës (UP) nuk ka një politikë të dokumentuar për identifikimin dhe aprovimin e kërkesave të reja të biznesit dhe të TI-së. Shumica e kërkesave të reja trajtohen në mënyrë ad-hoc, përmes takimeve apo bisedave telefonike, pa procesverbale apo dokumentim të detajuar mbi atë çfarë duhet të zhvillohet dhe si të realizohet.

Gjatë zhvillimit të moduleve të SEMS, Departamenti i TI-së ka pranuar kërkesa si nga përdoruesit fundorë (fakultetet), ashtu edhe nga menaxhmenti i UP-së, mirëpo këto kërkesa nuk janë dokumentuar në mënyrë formale dhe nuk ka ekzistuar një politikë e qartë për prioritizimin e zhvillimit të moduleve. Po ashtu mungon një sistem për menaxhimin e tiketave për aktivitetet e tyre.

Shkak për trajtimin e kërkesave ad-hoc dhe pa procesverbal është që stafi nuk ka qenë i informuar për rëndësinë dhe prioritetizimin e kërkesave, si dhe për mbajtjen e procesverbaleve e takimeve me qëllim dokumentimin e aktiviteteve.

Mungesa e procesit formal rrit rrezikun e keq-menaxhimit të kërkesave të biznesit dhe të TI-së, mund të shkaktojë vonesa në zbatimin e kërkesave, dyfishim të punëve, mungesë transparence dhe vendimmarrje jo të informuar. Kjo mund të ndikojë negativisht në efikasitetin operativ dhe në përmbushjen e nevojave të përdoruesve.

3.2. Kontraktimi

Organizatat duhet të kenë politika të cilat përcaktojnë se cilat funksione mund të kontraktohen dhe cilat funksione duhet të zhvillohen në ambientet e organizatës. Kontraktimi i shërbimeve në organizatë kërkon monitorim të afërt dhe është subjekt i kërkesave të privatësisë dhe sigurisë[13].

13 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative, Nënkontraktimi, Politikat e kontraktimit

Figura 5. Kontraktimi

3. Kodi burimor i SEMS-it nuk ishte në pronësi të UP-së nga viti 2016 deri në përfundim të auditimit.

Organizatat mbajnë njohuritë e biznesit dhe janë në gjendje të vazhdojnë operacionet brenda funksionit kritik nëse kontraktorët ose shitësit nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbimin. Organizata duhet të ketë të dokumentuar pronësisë e proceseve të biznesit[14].

Kodi burimor i SEMS-it fillimisht ishte në pronësi të UP-së, bazuar në kontratën e lidhur në vitin 2012, ku kërkohej që tre programerë nga OE të qëndronin në UP për arsye se nuk lejohej që kodi i SEMS-it të dilte jashtë UP-së. Më pas, në vitin 2016 sipas procesverbalit të datës 13 qershor 2016 i mbajtur ndërmjet UP-së dhe përfaqësuesve të OE-së, pronësia e kodit burimor është ndarë mes palëve: OE[15] i takon 70% dhe Universitetit të Prishtinës 30%, ndërsa autorësia e kodit burimor dhe e bazës së të dhënave i takonte OE-së. Kjo marrëveshje ishte përfshirë në kontratën për Mirëmbajtjen e SEMS me datë 15.06.2016. Si rezultat i kësaj marrëveshje janë kufizuar të drejtat e UP-së mbi Kodin burimor dhe UP ka humbur në mënyrë substanciale kontrollin mbi sistemin i cili është kyç në mbarëvajtjen e aktiviteteve të Universitetit të Prishtinës. Që nga ajo kohë, Kodi Burimor i takonte OE i cili ka vazhduar të mirëmbajë dhe administrojë sistemin, si dhe të zhvillojë module të reja sipas nevojave të paraqitura. Në praktikë, OE ka qenë përgjegjës për shqyrtimin dhe adresimin e çështjeve të ndryshme që lidhen me funksionimin e SEMS-it, përfshirë kërkesat dhe problemet e raportuara nga studentët dhe përdorues të tjerë të sistemit, si profesorë, asistentë dhe referentë. Në rastet kur zyrtarët e TI-së në nivel të UP-së nuk kanë qenë në gjendje të zgjidhin çështjet

14 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative, Mbajtja e njohurive të biznesit / Pronësia e proceseve të biznesit

15 Operastori ekonomik N.T.Sh UniSoft

e paraqitura, të gjitha kërkesat janë trajtuar nga OE, duke krijuar një varësi të konsiderueshme nga ky operator për funksionimin dhe zhvillimin e sistemit.

Gjatë periudhës së auditimit, UP ishte në proces negocimi me OE për rikthimin e pronësisë së kodit burimor. Në shkurt të vitit 2026 është nënshkruar kontrata e re ndërmjet palëve, me të cilën kodi burimor i SEMS-it është rikthyer në pronësi të UP-së. Administratorët e TI-së në UP kanë theksuar se kanë mungesë të stafit zhvillues në UP, megjithatë kjo nuk e arsyeton faktin e transferimit të kodit burimor në pronësi të OE.

Mospronësia e kodit burimor nga organizata krijon varësi të drejtpërdrejtë vetëm nga Operatori Ekonomik që ka zhvilluar sistemin për mirëmbajtjen, zhvillimin dhe ndryshimet në sistem. Kjo situatë kufizon mundësinë për angazhimin e operatorëve të tjerë, duke ulur konkurrencën dhe duke rritur kostot potenciale për institucionin.

4. Universiteti i Prishtinës nuk ka të detajuara në kontratë përgjegjësitë e OE

Marrëveshja në nivel shërbimi është baza për monitorimin dhe kontrollin e kontraktorit ose furnitorit kundrejt specifikimeve teknike[16].

Gjatë shqyrtimit të kontratës së lidhur ndërmjet Universitetit të Prishtinës (UP) dhe Operatorit Ekonomik (OE), është konstatuar se kontrata nuk përfshin elemente thelbësore për rregullimin e qartë dhe efektiv të ofrimit të shërbimit. Konkretisht, në kontratë nuk janë të përcaktuar kufijtë e përgjegjësive dhe ndarja e qartë e detyrave ndërmjet UP-së dhe OE-së, duke krijuar paqartësi lidhur me llogaridhënien. Po ashtu, mungojnë tregues të matshëm të performancës (indikatorë të performancës), të cilët do të mundësonin vlerësimin objektiv të cilësisë së shërbimit të ofruar. Kontrata nuk specifikon disponueshmërinë e shërbimit, menaxhimin e incidenteve, përfshirë kohën e reagimit dhe kohën e përgjigjes së sistemit, si dhe procedurat e raportimit të incidenteve dhe personat përgjegjës për njoftim. Për më tepër, nuk janë të trajtuara çështje kritike që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale (Numri personal, emri, mbiemri, notat, etj), si dhe frekuenca e ruajtjes së kopjeve rezervë (backup). Mungesa e këtyre elementeve e kufizon mundësinë e UP-

16 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative, Marrëveshja në Nivel Shërbimi (SLA)

së për të monitoruar performancën e OE-së, rrit rrezikun operativ dhe ligjor, si dhe vështirëson ndërmarrjen e masave korrigjuese në rast të mosrespektimit të shërbimit të kontraktuar.

Mosplanifikimi i qartë i vazhdimësisë së shërbimit rrit rrezikun e ndërprerjeve të paplanifikuara, pa pasur bazë kontraktuale për të kërkuar përmirësim apo kompensim. Po ashtu, mungesa e rregullimit të menaxhimit të incidenteve, përfshirë kohën e reagimit dhe kohën e përgjigjes së sistemit, mund të rezultojë në zgjatje të ndërprerjeve dhe ndikim negativ në proceset akademike dhe administrative të UP-së. Mosdefinimi i procedurave për raportimin e incidenteve dhe personave përgjegjës për njoftim krijon rrezik për vonesa në reagim dhe mungesë koordinimi ndërmjet palëve. Për më tepër, mungesa e dispozitave lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale rrit rrezikun e shkeljeve ligjore dhe cenimit të privatësisë së përdoruesve. Së fundi, mosparashikimi i frekuencave të kopjeve rezervë (backup) rrit rrezikun e humbjes së të dhënave dhe pamundëson rikuperimin e shpejtë të sistemit në rast të incidenteve teknike.

5. Ekzistojnë hapësira kohore në mes të kontratave të lidhura nga Universiteti i Prishtinës me Operatorin Ekonomik

Organizata duhet të sigurojë vazhdimësinë e kontratave me ofruesit e shërbimeve, përmes planifikimit dhe rinovimit në kohë, në mënyrë që të shmangen ndërprerjet e shërbimeve dhe boshllëqet kontraktuale[17].

Ne kontratat ne mes te UP dhe OE ekzistojnë hapësira të konsiderueshme kohore ndërmjet periudhave kontraktuale. Konkretisht, janë identifikuar dy raste kur shërbimet janë zhvilluar pa mbulim kontraktual: Një hapësirë kohore prej rreth 11 muajsh ndërmjet kontratës së parë dhe kontratës pasuese; dhe një hapësirë kohore prej rreth 6 muajsh pas skadimit të kontratës së fundit më 14.07.2025, gjatë së cilës, deri në momentin e kryerjes së auditimit, nuk ishte lidhur ende një kontratë e re.

17 ISO 27001 (versioni 2022) – Supplier controls (A.5.19–A.5.23)

Shkak për hapësirën kohore parë ka qenë kërkesa e menaxhmentit që mirëmbajtja të vazhdojë të kryhet nga Zyra e TI-së në kuadër të UP-së. Ndërsa, për hapësirën e dytë, arsyeja ka qenë se UP dhe OE kanë qenë në negociata lidhur me kalimin e pronësisë së kodit burimor të SEMS. Hapësirat kohore ndërmjet kontratave të lidhura me Operatorin Ekonomik, i cili është përgjegjës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e platformës SEMS, kanë rritur mundësinë për ndikim negativ në funksionimin dhe sigurimin e shërbimeve. Gjatë periudhave pa kontratë nuk ka pasur obligime të qarta ligjore dhe financiare ndaj Operatorit, gjë që ka rritur rrezikun që Universiteti i Prishtinës të mos ketë mbulim të qartë ligjor për të kërkuar përgjegjësi në rast vonesash, defekteve ose shkeljesh të standardeve. Për më tepër, këto ndërprerje ndikojnë në vonesa në mirëmbajtje dhe zhvillim të platformës. Përveç këtyre, boshllëqet kontraktuale ndikojnë në rrezikun e vazhdimësisë operacionale, duke cenuar sigurinë, funksionalitetin dhe integritetin e saj.

3.3. Kontrollet e Aplikacionit

Kontrollet e aplikacionit janë: kontrolli mbi funksionin e hyrjes, të përpunimit, të daljes dhe sigurisë. Ato përfshijnë metoda për të siguruar që: vetëm të dhëna të plota, të sakta, të vlefshme dhe të besueshme vendosen dhe azhurnohen në një sistem të informacionit, përpunimi realizon detyrën e saktë dhe rezultati i përpunimit plotëson pritjet dhe të dhënat ruhen[18]. Objektivi i matjeve të kontrolleve të procesimit është kërkimi për mbrojtjen e integritetit, vlefshmërisë dhe besueshmërisë së të dhënave, si dhe mbrojtja e tyre kundrejt gabimeve në procesim gjatë ciklit të përpunimit të transaksionit nga momenti i marrjes së të dhënës nga nënsistemi i hyrjes deri në momentin që e dhëna dërgohet në bazën e të dhënave, në komunikim ose në nënsistemin e daljes[19].

Llojet e kontrollit përfshijnë kontrollimin e gabimeve në sekuencat dhe dyfishimet, numërimin e transaksioneve/regjistrimeve[20].

18 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative – Kontrollet e aplikacioneve
19 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative, Kontrollet e procesimit/përpunimit
20 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative, Kontrollet e procesimit/përpunimit

Figura 6. Kontrollet e aplikacionit (Kontrollet e procesimit)



6. Universiteti i Prishtinës ka mangësi ne menaxhimin e privilegjeve të roleve

Sistemi duhet të sigurojë që çdo përdorues të ketë vetëm privilegjet që i takojnë sipas rolit të tij. Aplikacioni identifikon në mënyrë korrekte gabimet në transaksione. Integriteti i të dhënave ruhet edhe gjatë ndërprerjeve të rastësishme në përpunimin e transaksioneve. Duhet te ketë mekanizëm i përshtatshëm për trajtimin e gabimeve në përpunim, rishikim dhe qartësim të dosjeve në pezullim[21].

Menaxhimi i përdoruesve në sistemin SEMS nuk realizohet nga Zyra Qendrore e TI-së dhe nuk ekziston një procedurë e standardizuar për krijimin, miratimin dhe menaxhimin e qasjeve në sistem. Administratorët e TI-së në fakultete kanë qasje të plotë për të krijuar, menaxhuar dhe modifikuar llogaritë e përdoruesve, përfshirë rolet si Dekan/Prodekan, Profesor, Asistent dhe Referent, pa një mekanizëm të centralizuar kontrolli dhe miratimi.

Administratorët kanë dhënë qasje me privilegje të zyrtarit të TI-së personave pa procedurë formale apo autorizim zyrtar. Sipas deklarimeve të zyrtarëve përgjegjës, këto qasje janë dhënë për shkak të mungesës së stafit gjatë periudhës së grevës në sektorin e TI-së. Gjithashtu, në fakultete të caktuara, zyrtarët për mësim kanë pasur njëkohësisht qasje edhe si referent, duke krijuar mbivendosje të roleve dhe duke rritur rrezikun e keqpërdorimit ose gabimeve.

Po ashtu, janë identifikuar raste kur administratorët e TI-së kanë pasur qasje edhe me role operative, si referent në fakultete të caktuara, gjë që bie ndesh me parimin

21 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative, Përpunimi

e ndarjes së detyrave. Në raste të tjera, është konstatuar përdorimi i llogarive të përbashkëta (p.sh. "Referent Mjekësi"), të cilat përdoren nga zyrtar te ndryshëm, duke e bërë të pamundur gjurmimin e aktiviteteve individuale dhe duke dobësuar kontrollin dhe llogaridhënien.

Mungesa e një ambienti testues ka ndikuar në krijimin e llogarive shtesë me role të ndryshme në sistemin prodhues për qëllime testimi ose operacionale. Një rast i tillë është evidentuar gjatë procesit të përpilimit të kontratës së re, ku është krijuar një llogari e veçantë që është përdorur nga disa persona, duke rritur rrezikun për sigurinë dhe integritetin e sistemit.

Në përgjithësi, mungesa e një procesi të centralizuar dhe të standardizuar për menaxhimin e përdoruesve, mbivendosja e roleve, dhënia e qasjeve pa autorizim formal dhe përdorimi i llogarive të përbashkëta rrisin ndjeshëm rrezikun e qasjes së paautorizuar, keqpërdorimit të privilegjeve dhe dobësimit të kontrollit dhe sigurisë së sistemit SEMS.

I gjithë ky proces bëhet edhe më i ndjeshëm për shkak se në SEMS nuk ka një zyrtar të dedikuar për monitorimin e aktiviteteve në sistem.

Gjatë analizës së hapjes së afateve në fakultetet mostër , kemi vërejtur hapje të shpeshta të afateve. Ne kemi pyetur zyrtarët përgjegjës për arsyet e këtyre hapjeve dhe kemi kërkuar dëshmi për secilin rast. Megjithatë, nga emailat e pranuara kemi marrë informacion se dokumentimi i çdo hapjeje është i pamundur, pasi shpesh ato bëhen vetëm përmes telefonit ose mesazheve dhe nuk ka mundësi për regjistrim të detajuar.

7. SEMS u mundëson profesorëve që të mbajnë dy lëndë të ndryshme në kohën e njëjtë.

Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në përputhje me sjelljen e pritur. Aplikacioni identifikon në mënyrë korrekte gabimet në transaksione. Integriteti i të dhënave ruhet edhe gjatë ndërprerjeve të rastësishme në përpunimin e

transaksioneve. Duhet te ketë mekanizëm i përshtatshëm për trajtimin e gabimeve në përpunim, rishikim dhe qartësim të dosjeve në pezullim[22].

Gjatë ekzaminimit të vijueshmërisë së profesorëve në fakultetet moster për periudhën 2023–2025, nga mostra prej 21 profesorë, u identifikuan gjithsej 86 raste kur të njëjtëve profesorë u janë regjistruar në platformën SEMS dy ligjërata për lëndë të ndryshme, të planifikuara në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën sallë. Si rezultat i këtij regjistrimi në sistem, profesorëve u janë llogaritur dy orë mësimore të mbajtura, ndërkohë që në praktikë është zhvilluar vetëm një orë mësimore. Në Fakultetin Ekonomik, zyrtari për mësim ka vërejtur këtë lëshim, duke reaguar ndaj rasteve të identifikuara dhe duke ndërmarrë veprime për korrigjimin e regjistrimeve në sistemin SEMS. Një praktikë e tillë monitorimi dhe reagimi nuk është evidentuar në fakultetet e tjera të përfshira në mostër.

Platforma SEMS, në konfigurimin aktual, lejon regjistrimin e më shumë se një ligjërate për profesorin e njëjtë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën sallë, pa vendosur kufizime apo kontrolle automatike parandaluese. Mungesa e kontrolleve automatike në sistem. për mbivendosjen e orarit dhe lokacionit krijon mundësi që profesori të regjistrojë dy ligjërata të ndryshme në të njëjtin interval kohor, duke rezultuar në llogaritje të pasaktë të orëve të mbajtura. Duke qenë se kompensimi i profesorëve bazohet në numrin e orëve të mbajtura dhe të raportuara në SEMS, kjo situatë mund të rezultojë në pagesa jo të sakta, përkatësisht në mbivlerësim të angazhimit mësimor.

Njëkohësisht, mbajtja faktike e vetëm një ore mësimore në rastet kur në sistem raportohen dy orë, ndikon drejtpërdrejt në realizimin e planprogramit dhe cenon të drejtën e studentëve për të përfituar numrin e plotë të orëve të përcaktuara. Kjo situatë dëmton cilësinë e procesit mësimor, besueshmërinë e të dhënave në sistem dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm në menaxhimin e ngarkesës akademike.

22 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative, Përpunimi

8. Fakulteti i mjekësisë nuk përdor platformën SEMS për vijueshmëri të profesorëve dhe studenteve

SEMS duhet të përdorët për regjistrimin dhe monitorimin e vijueshmërisë së profesorëve dhe studentëve, në mënyrë që të sigurohet funksionim i saktë dhe i plotë i proceseve akademike në përputhje me kërkesat e sistemit[23].

Në Fakultetin e Mjekësisë, me te gjitha njësitë e tij, sistemi SEMS nuk përdoret në mënyrë të plotë. Aktualisht, SEMS shfrytëzohet kryesisht për menaxhimin e notave, afateve të provimeve dhe disa procese të tjera administrative. Megjithatë, regjistrimi i orëve mësimore dhe monitorimi i vijueshmërisë së studentëve vazhdojnë të bëhen përmes listave fizike. Kjo praktikë kufizon ndjeshëm transparencën dhe llogaridhënien, duke rritur rrezikun e raportimeve të pasakta. Për më tepër, përdorimi i kufizuar i SEMS e zvogëlon mundësinë për kontroll automatik dhe monitorim efektiv të proceseve mësimore.

Një nga arsyet kryesore për këtë situatë është mungesa e infrastrukturës brenda Fakultetit të Mjekësisë, e cila pengon operimin e plotë dhe funksional të sistemit SEMS.

9. Mungesa e digjitalizimit të pagesave për studentët në platformën SEMS

Transaksionet e pagesave në platformë duhet të ekzekutohen saktë, të plota dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara[24].

Digjitalizimi i pagesave për studentët në platformën SEMS ende nuk është realizuar. Studenti përmes platformës mund të gjenerojë fletëpagesën, por nuk mund ta realizojë pagesën në mënyrë elektronike. Si rrjedhojë, studenti gjeneron fletëpagesën në SEMS, e printon atë dhe e kryen pagesën fizikisht në institucione bankare. Më pas, dëshminë e pagesës e dorëzon në formë fizike te referentët, të cilët e regjistrojnë pagesën në platformë. Kjo procedurë shkakton punë shtesë për referentët, kosto shtesë për studentët dhe humbje kohe për të dyja palët.

23 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative - Përpunimi
24 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative - Përpunimi

Po ashtu, edhe pse sistemi ka ndërlidhje me ARC-në(Agjencia për Regjistrim Civil), të pagesat, disa të dhëna të studentëve duhet të regjistrohen manualisht, gjë që rrit mundësinë e gabimeve gjatë futjes së të dhënave. Në platformën SEMS, kjo kërkesë teknikisht është e realizueshme. Megjithatë, organizata ka theksuar se kanë hasur vështirësi në bashkëpunim me institucionet bankare.

Digjitalizimi nuk është implementuar plotësisht edhe në regjistrimin e studentëve të rinj. Pas pranimit në fakultet, studenti përgatit dosjen fizike, bën fotografimin dhe dorëzon dokumentet në administratë. Më pas, ai duhet të shkojë në zyrën qendrore të TI-së për të ripërsëritur fotografimin.

3.4. Plani i Vazhdimësisë së Biznesit-PVB dhe Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia-PRF

Planifikimi efektiv i vazhdimësisë fillon me krijimin e një politike të vazhdimësisë së biznesit të një organizate. Nëse rimëkëmbja nga fatkeqësitë të një fushe kritike funksionale rrezikohet, do të rrezikohet vazhdimësia e biznesit (veprimtarisë)[25]. Plani i rimëkëmbjes nga fatkeqësitë duhet të hartohet në mënyrë që të bëhet rivendosja e aplikacioneve kritike; kjo përfshin aranzhime për hapësirat alternative të procesimit në rast se objektet kryesore dëmtohen dukshëm ose janë të pa qasshme[26].

25 Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, PVB – PRF.
26 Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Politikat e Vazhdimësisë së Biznesit.

Figura 7. Plani i Vazhdimësisë së Biznesit – Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia



10. SEMS nuk ka një plan apo politikë për vazhdimësinë e biznesit dhe nuk disponon një ambient testues.

Organizata duhet te këtë politikat organizative mbi vazhdimësinë e biznesit, të cilat përmbajnë detyrat dhe përgjegjësitë, qëllimin, kriteret e alokimit të burimeve/ parimet, kërkesat për trajnim, orar të mirëmbajtjes, orarin e testimeve, planet backup, si dhe nivele e aprovimit[27].

SEMS nuk ka një plan apo politikë për vazhdimësinë e biznesit, e cila do të përcaktonte qartë veprimet që duhet të ndërmerren në rast të një fatkeqësie apo ndërprerjeje të sistemit. Për SEMS ekziston një rregullore që udhëzon përdoruesit, mirëpo kjo rregullore nuk përmban politika dhe procedura konkrete për sigurimin e vazhdimësisë së biznesit. Rregullorja fokusohet kryesisht në përshkrimin e funksioneve të sistemit. Kjo rregullore është e mangët dhe nuk është përditësuar

27 Manuali i Auditimit të Teknologjisë Informative,

që nga viti 2020, pavarësisht se ndërkohë në SEMS janë shtuar dhe avancuar shumë procese dhe funksionalitete.

Përgjegjës për proceset e backup-it dhe administrimit të sistemeve është Administrator i databazës, e cila pozite është vakante tash e dy vite. Aktualisht, këto detyra realizohen ne baza ditore nga zyrtarë të tjerë të TI-së dhe operatori ekonomik që mirëmban sistemin SEMS, pa pasur procedura të dokumentuara dhe të standardizuara që udhëzojnë veprimet që duhet të ndërmerren në rast të një fatkeqësie ose ndërprerjeje të sistemeve.

Gjithashtu organizata nuk posedon një ambient testues. Në mungesë të një ambienti testues, zhvillimet në sistem, si përditësimet apo zhvillimet e moduleve, aplikohen drejtpërdrejt në ambientin real. Moduli i zhvilluar testohet vetëm nga zhvilluesit e Operatorit Ekonomik dhe më pas vendoset direkt në ambientin real. Kjo rrit rrezikun e ndërprerjes së shërbimeve, pasi çdo gabim gjatë implementimit mund të ndikojë drejtpërdrejt në funksionimin normal të sistemit. Po ashtu, kur lind nevoja për asistim për ndonjë problem të caktuar, Zyra e TI-së duhet të ketë qasje të drejtpërdrejtë me role reale në sistem për të identifikuar burimin e problemit dhe për të ofruar asistencën e nevojshme.

Poashtu një qendër e dytë për rimëkëmbje nga fatkeqësitë është thelbësore për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit të sistemeve në rast të incidenteve të papritura, si dështimet teknike, sulmet kibernetike apo fatkeqësitë natyrore. Ajo mundëson rikthimin e shpejtë të të dhënave dhe shërbimeve kritike, duke minimizuar ndërprerjet dhe humbjen e të dhënave. Gjithashtu, rrit sigurinë, besueshmërinë dhe integritetin e sistemeve, duke garantuar që operacionet të vazhdojnë me ndikim minimal ndaj përdoruesve dhe institucionit.

KONKLUZIONET

04

4. Konkluzionet

SEMS ofron mbështetje efektive për funksionet kryesore akademike dhe administrative të UP-së. SEMS ka avancuar në digjitalizimin e proceseve për përdoruesit, duke lehtësuar mësimin dhe duke digjitalizuar proceset mësimore e administrative, si dhe duke rritur transparencën dhe efikasitetin. Megjithatë, sistemi përballet ende me sfida në shtrirjen e tij në të gjitha fakultetet, kontrollin e aplikacioneve, kontraktimin, qeverisjen e TI-së dhe PVB/PRF (Plani i Vazhdimësisë së Biznesit – Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia).

Qeverisja e TI

SEMS ka mungesë të politikave dhe procedurave të dokumentuara për operacionet e biznesit dhe qeverisjen e TI-së, si dhe mosfunksionimi i një mekanizmi të strukturuar për monitorimin e vazhdueshëm të log-eve dhe aktiviteteve të sistemit, paraqet një dobësi thelbësore në kontrollin dhe sigurinë e SEMS. Mosplotësimi i pozitave kyçe, si Administratori i Databazës dhe Zyrtari për Siguri Kibernetike, pavarësisht parashikimit në rregullore, dobëson më tej kapacitetin institucional për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e sistemeve kritike. Mungesa e enkriptimit të të dhënave të studentëve rrit ndjeshëm rrezikun e ekspozimit dhe keqpërdorimit të të dhënave personale. Pa mekanizma adekuatë të enkriptimit, të dhënat e ruajtura në databazë mund të jenë më të cenueshme ndaj qasjes së paautorizuar, sulmeve kibernetike ose rrjedhjes së informacionit.

Mungesa e një plani të dokumentuar dhe e një procesi formal për identifikimin, vlerësimin dhe aprovimin e kërkesave të biznesit dhe të TI-së paraqet dobësi të konsiderueshme në qeverisjen dhe menaxhimin e zhvillimeve në SEMS.

Kontraktimi

Mungesa e pronësisë së plotë të kodit burimor dhe dobësitë kontraktuale në menaxhimin e SEMS kanë krijuar varësi të lartë nga Operatori Ekonomik dhe kanë ekspozuar Universitetin ndaj rreziqeve operative, ligjore dhe financiare.

Poashtu në kontrata nuk përfshin mjaftueshëm kërkesat dhe masat për sigurinë e informacionit, siç janë: klauzola për mbrojtjen e të dhënave dhe përgjegjësitë e palëve në projekt në raste incidentesh. Ndërprerjet kohore ndërmjet kontratave dhe mungesa e planifikimit të qëndrueshëm kontraktuale kanë krijuar pasiguri në ofrimin e shërbimeve, duke rritur mundësinë e ndërprerjeve, vonesave në mirëmbajtje dhe zhvillim, si dhe rreziqe ligjore e financiare për institucionin.

Kontrollet e Aplikacionit

Auditimi i sistemit SEMS ka evidentuar mangësi që ndikojnë në menaxhimin e proceseve akademike dhe kontrollin e qasjeve. Moduli i pagesave dhe moduli i profesorit kanë mangësi në zhvillim dhe përdorim. Këto përfshijnë duplifikim të orëve dhe mbivendosje të ligjëratave, mungesë digjitalizimi të pagesave, përdorim të pjesshëm të sistemit në Fakultetin e Mjekësisë, si dhe menaxhim jo të centralizuar të privilegjeve dhe roleve.

Dobësitë në dhënien e privilegjeve pa autorizim formal, mbivendosjen e roleve dhe përdorimin e llogarive të përbashkëta rrisin rrezikun dhe ndikojnë negativisht në efikasitetin, saktësinë dhe sigurinë e proceseve.

Plani i Vazhdimësisë së Biznesit – Plani i Rikthimit nga Fatkeqësia

SEMS nuk ka një politikë efektive për vazhdimësinë e biznesit dhe rikthimin nga fatkeqësitë, pasi mungojnë procedurat dhe infrastruktura e nevojshme, përfshirë një qendër dytësore funksionale.

Mungesa e një ambienti testues rrit rrezikun e paraqitjes së gabimeve në sistem, pasi zhvillimet dhe përditësimet aplikohen drejtpërdrejt në ambientin real pa një proces të plotë testimi paraprak. Si dhe mungesa e një qendre të dytë për rimëkëmbje nga fatkeqësitë rrit rrezikun e ndërprerjes së shërbimeve dhe humbjes së të dhënave në rast të incidenteve të papritura, si dështimet teknike, sulmet kibernetike apo fatkeqësitë natyrore. Kjo situatë mund të ndikojë negativisht në vazhdimësinë e operacioneve dhe në aftësinë e institucionit për të rikthyer shpejt sistemet dhe të dhënat kritike.

REKOMANDIMET

05

5. Rekomandimet

Rekomandojmë Universitetin e Prishtinës, lidhur me Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Studentëve - SEMS, që:

1. Qeverisja e TI, Politikat dhe procedurat, menaxhmenti i UP-së të hartojë, miratojë dhe komunikojë politika dhe procedura formale për operacionet e biznesit, për të siguruar udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e operacioneve të përditshme për administrimin e sistemeve të informacionit dhe sigurisë së tyre. Këto politika dhe procedura duhet të përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë, të standardizojnë proceset kryesore të biznesit dhe të sigurojnë zbatim të njëtrajtshëm në të gjithë organizatën, duke u rishikuar dhe përditësuar periodikisht.

1.1 Menaxhimi i rrezikut, UP të hartojë dhe të aprovojë politika dhe plane të menaxhimit të rrezikut për sistemin SEMS. Duhet të vendosen mekanizma për monitorim të vazhdueshëm dhe periodik të log-eve dhe aktiviteteve të sistemit, si dhe procedura për reagim të shpejtë ndaj incidenteve të sigurisë. Po ashtu, rekomandohet që UP duhet të sigurojë menaxhim optimal dhe efektiv të burimeve, duke mbuluar pozitat kyçe.

2. Përcaktimi i kërkesave të TI-së, Universiteti i Prishtinës të hartojë dhe aprovojë një plan dhe proces të dokumentuar për identifikimin dhe aprovimin e kërkesave të biznesit dhe të TI-së. Ky proces të përfshijë mënyrën e regjistrimit dhe dokumentimit të kërkesave, klasifikimin sipas rëndësisë dhe burimit, përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive për shqyrtim dhe aprovimin e kërkesave nga Komiteti Drejtues.

3. Kontraktimi, Universiteti i Prishtinës (UP) për sistemet qe zhvillon të ndërmarrë masa për të siguruar kalimin e pronësisë së Kodit Burimor, përfshirë përfshirjen e dispozitave të qarta kontraktuale në kontratat me Operatoret Ekonomik. Njëkohësisht, UP duhet të vlerësojë nevojën për ndërtimin e kapaciteteve të brendshme zhvilluese, ose të përcaktojë mekanizma alternativë për menaxhimin dhe zhvillimin e SEMS, me qëllim uljen e varësisë nga Operatorët e jashtëm dhe sigurimin e vazhdimësisë, sigurisë dhe qëndrueshmërisë afatgjate të sistemit.

4. Marrëveshja në Nivel Shërbimi (SLA), Departamenti i TI-së të siguroj që Marrëveshja në Nivel Shërbimi (SLA) me Operatorët Ekonomik, të përcaktoj qartë përgjegjësitë, indikatorë të matshëm të performancës, procedura për menaxhimin e incidenteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, shpeshtësia e backup-it duhet të përcaktohet në politika dhe të zbatohet nga pala përgjegjëse. Këto masa forcojnë kontrollin kontraktual dhe përmirësojnë sigurinë e shërbimit.

5. Siguria e kontraktimit, të vendosën mekanizma të qartë për planifikimin dhe rinovimin në kohë të kontratave me Operatorin Ekonomik, në mënyrë që të shmangen hapësirat kohore ndërmjet kontratave, të sigurohet vazhdimësia e shërbimeve dhe të ulet rreziku ligjor, financiar dhe operacional për platformën SEMS.

6. Menaxhimi dhe qasja e përdoruesve, të realizohet përmes kontrolluesit të Domenit (Domain Controller), ku përcaktohen rolet dhe qasjet në SEMS sipas funksioneve përkatëse, duke siguruar kontroll të centralizuar dhe reduktim të qasjeve të paautorizuara.

6.1 Politikat për menaxhimin e qasjes, të hartohen me llogari të personalizuara dhe të standardizuara. Të rishikohen të drejtat e qasjes së përdoruesve në SEMS së paku çdo 6 muaj, për të siguruar përshtatshmërinë me funksionet e tyre.

7. Kontrollet e aplikacionit – kontrollet e përpunimit, përmirësimin e konfigurimit të sistemit SEMS duke integruar kontrolle automatike parandaluese, të cilat të mos lejojnë regjistrimin e më shumë se një ligjërate për profesorin e njëjtë në të njëjtin interval kohor dhe në të njëjtën sallë. Sistemi duhet të përmbajë validime të detyrueshme që bllokojnë mbivendosjen e orarit dhe lokacionit para finalizimit të regjistrimit.

7.1 Monitorimi aktiviteteve në sistem, të sigurohet vendosja e një mekanizmi të rregullt monitorimi të orëve mësimore në nivel fakulteti, me përgjegjësi të qartë për zyrtarët për mësim, me qëllim identifikimin dhe korrigjimin në kohë të çdo mospërputhjeje në raportimin e orëve mësimore. Në rastet kur kompensimi financiar bazohet në të dhënat e SEMS, menaxhmenti duhet të sigurojë verifikim shtesë të saktësisë së orëve të raportuara, deri në funksionalizimin e plotë të kontrollit sistemor.

8. Përdorimi i Sistemit, të bëhet shtrirja e SEMS-it në të gjitha fakultetet dhe të funksionalizohet regjistrimi elektronik i lëndëve dhe vijueshmërisë, duke eliminuar listat fizike dhe duke rritur saktësinë dhe efikasitetin.

9. Shërbimet dhe pagesat dixhitale, të ndërmerren veprime konkrete për funksionalizimin e pagesave dixhitale në SEMS, duke siguruar integrimin e plotë të procesit të pagesave për të reduktuar kostot, ngarkesën administrative dhe humbjen e kohës për studentët dhe stafin administrativ. Poashtu në momentin që studenti dorëzon dosjen e tij me fotografinë e bashkëngjitur, ajo fotografi të ngarkohet automatikisht në sistem, në mënyrë që të mos ketë nevojë të dërgohet përsëri.

10. PVB//PRF - Plani i Vazhdimësisë së Biznesit, të hartohen politika dhe procedura për vazhdimësinë e biznesit, në përputhje me Standardet e TI-së.

10.1 Plani për vazhdimësinë e biznesit, të hartohen procedura të dokumentuara dhe standardizuara për realizimin e backup-eve dhe rikuperimin e të dhënave, si dhe raportimin e këtyre veprimeve.

10.2 Qendra për rimëkëmbje, organizata duhet të ndërmarrë hapa për të siguruar rikthimin në kohë të sistemeve kritike, duke vlerësuar dhe shfrytëzuar në mënyrë efikase burimet ekzistuese dhe krijimin e infrastrukturës/opsioneve adekuate.

10.3 Krijimin e një ambienti testues për sisteme, i cili mundëson verifikimin dhe testimin e ndryshimeve dhe planeve të rikuperimit pa rrezikuar sistemet operative.

SHTOJCA I

Shtojca I. Dizajni i auditimit

Fushat me rrezik, treguesit e problemit të auditimit dhe materialiteti

SEMS është një ndër sistemet më të rëndësishme të Universitetit të Prishtinës. Ka rol kyç për efikasitetin dhe transparencën e menaxhimit akademik dhe administrativ në institucion si dhe është i rëndësishëm në shërbimet për studentët që ofrohen në mënyrë elektronike, duke ua lehtësuar punën dhe kursyer kohë. Materialiteti i tij është i lartë jo vetëm për shkak të rolit operacional, por edhe për ndikimin që ka në transparencë, integritetin e të dhënave dhe cilësinë e shërbimeve për një numër të madh përdoruesish.

Sistemi funksionon në të gjitha njësitë akademike të Universitetit dhe mbulon gjithsej 14 fakultete. Rëndësia strategjike e SEMS reflektohet edhe në investimin financiar të universitetit: kontrata e fundit trevjeçare vetëm për mirëmbajtje dhe zhvillim ka një vlerë totale prej 360,000 euro.

Gjatë fazës parastudimore pasi që shqyrtuam dokumentet relevante, si dhe intervistave me zyrtarët përgjegjës për platformën, u identifikua se ekzistojnë dobësi të rëndësishme që përbëjnë rrezik të lartë për funksionimin dhe sigurinë e SEMS-it.

Më poshtë janë evidentuar fushat me rrezik si:

- Qeverisja e TI-së paraqet dobësi, pasi mungojnë politikat e dokumentuara të sigurisë së informacionit, proceset e standardizuara për zhvillimin dhe prioritizimin e moduleve, si dhe përcaktimet e qarta të roleve dhe përgjegjësive në mes të OE dhe Departamentit tëtë TI-së në kuadër të UP-së. Këto mangësi krijojnë paqartësi organizative, rrisin ekspozimin ndaj rreziqeve të sigurisë dhe kufizojnë kontrollin mbi funksionet kritike të sistemit.
- Kontraktimi paraqet rreziqe të theksuara, pasi kontratat e mirëmbajtjes lidhen për periudha 3 vjeçare dhe krijojnë hapësira disa mujore në mes

të kontratave pa mbulim teknik, duke shtuar mundësinë për ndërprerje të shërbimeve dhe humbje të të dhënave. Po ashtu, varësia e lartë nga kontraktori zhvillues për funksionimin dhe ndërhyrjet teknike të sistemit rrit ekspozimin e organizatës ndaj rreziqeve në rast të ndërprerjes së marrëdhënies kontraktuale ose nevojës për mbështetje urgjente.

- Mos-shtrirja e SEMS-it në të gjitha njësitë akademike rrezikon funksionimin e qëndrueshëm të proceseve akademike dhe administrative.
- Mungesa e planit të vazhdimësisë së biznesit dhe planit të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë nënkupton se institucioni nuk ka mekanizma të dokumentuar për të garantuar funksionimin e SEMS-it në rast emergjencash apo prishjesh teknike. Po ashtu, mungesa e një ambienti testues dhe e një qendre për rikuperim rrit rrezikun për funksionimin e SEMS-it.

Shqyrtimi i treguesve të problemit të identifikuar nga burime të ndryshme, takimet e mbajtura me personat përgjegjës për identifikimin e çështjeve për SEMS-in, si dhe nga vlerësimet tona të bazuara në Manualin Aktiv të Auditimit të TI-së[28] për identifikimin e fushave më me rrezik nga dokumentacioni i pranuar na orienton në problemin kryesor: SEMS përballet me problemet kryesore në fushën e qeverisjes, kontraktimin, vazhdimësisë se biznesit dhe kontrolle të aplikacionit, të cilat kërkojnë vlerësim të detajuar gjatë fazës së auditimit.

Përshkrimi i sistemit

3.1. Universiteti i Prishtinës

Universiteti i Prishtinës është themeluar me Ligjin mbi themelimin e Universitetit më 18 nëntor 1969 dhe funksionon në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës[29]. Universiteti gëzon autonominë dhe lirinë e mësimdhënies akademike, të kërkimeve shkencore, krijimtarisë artistike, si dhe autonominë financiare brenda veprimtarisë së tij.

28 Manuali Aktiv i Auditimit - është platformë e zhvilluar nga ITWG/EUROSAI dhe WGITA/INTOSAI, që përdoret për identifikimin e fushave më me rrezik, përcaktimin e pyetjeve, kritereve dhe metodologjisë së punës gjatë procesit të auditimit të TI-së.

29 Statuti i UP-së

Universiteti i Prishtinës përbëhet nga këto njësi akademike: Fakultetin Filozofik, Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetin e Filologjisë, Fakultetin Juridik, Fakultetin Ekonomik, Fakultetin i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Arteve, Fakultetin e Bujqësisë, Fakultetin e Shkencave Sportive, Fakultetin e Edukimit, Fakulteti i Arkitekturës.

Figura 8. Shtrirja e SEMS në fakultet e UP-se



Fushëveprimi - Universiteti ka këto të drejta dhe detyra: Të zgjedhë në mënyrë autonome autoritetet qeverisëse dhe menaxhuese dhe të përcaktojë mandatin e tyre; Të rregullojë strukturat dhe aktivitetet e tij përmes rregullave të universitetit, mbështetur në dispozitat e këtij statuti, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë

dhe me akte të tjera nënligjore, të nxjerra prej tij dhe në përputhje me ligjet tjera në fuqi; Të zgjedhë personelin akademik dhe personelin tjetër, të përcaktojë kushtet shtesë për pranimin e studentëve dhe metodat e mësimdhënies e të vlerësimit të studentëve, të miratuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim; Të hartojë dhe zbatojë, në mënyrë të pavarur, programet studimore, kërkimet shkencore dhe projektet artistike; Të bëjë përzgjedhjen e fushave për studim; Të japë tituj për profesorët dhe personelin tjetër, në pajtueshmëri me Ligjin për Arsimin e Lartë, me ligjin në fuqi për punësim, si dhe skemën e miratuar nga AKA-ja.

Vizioni - Universiteti i Prishtinës është një institucion i arsimit të lartë, i njohur globalisht për profesionalizëm, integritet, mësimdhënie cilësore dhe hulumtim. Në harmonizim me nevojat e ekonomisë dhe të tregut, do të vendosë dhe mirëmbajë standarde të cilësisë, duke përkrahur mobilitetin dhe zhvillimin e karrierave akademike për personelin dhe studentët, duke e rritur numrin e partnerëve dhe duke iu bashkuar rrjetit të edukimit të lartë evropian.

Misioni - Misioni i UP-së bazohet në zhvillimin akademik, hulumtimet shkencore, artistike dhe sigurimin e arsimit të lartë përmes programeve me interes strategjik dhe zhvillimor të Republikës së Kosovës. Universiteti mundëson mobilitetin e programeve, studentëve dhe stafit akademik në vazhdimësi, me qëllim të arritjes së nivelit ndërkombëtar dhe konkurrencës në treg. Universiteti është institucion publik autonom i arsimit të lartë, që zhvillon arsimin akademik, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike.

Struktura organizative - Autoritetet kryesore qeverisëse dhe menaxhuese të universitetit janë: Këshilli drejtues, senati dhe rektori. Senati është organi më i lartë akademik i universitetit. Atë e kryeson rektori i universitetit, i cili është autoriteti kryesor menaxhues i universitetit. Rektori është udhëheqësi kryesor akademik e administrativ dhe është përgjegjës për punën efektive dhe të rregullt të universitetit dhe për menaxhimin e tij sipas politikës së përcaktuar nga Këshilli Drejtues. Rektorin e ndihmojnë prorektorët dhe sekretari i përgjithshëm i universitetit. Detyrat e prorektorëve caktohen nga rektori, në pajtim me dispozitat e Statutit të UP-së[30].

30 Statuti i UP-së

Figura 9. Struktura Organizative e UP-së



Këshilli Drejtues - është organi kryesor qeverisës i universitetit. Ai ka përgjegjësi të përgjithshme strategjike për funksionimin efektiv institucional të universitetit dhe është përgjegjës për të gjitha vendimet në lidhje me çështjet financiare (buxheti, personeli, infrastruktura), në mënyrë që të sigurojë kushte të përshtatshme për veprimtarinë e qëndrueshme të universitetit në përputhje me obligimet e tij.

Senati - është organi më i lartë akademik i universitetit dhe përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm me të drejtë vote: Rektori, prorektorët, dekanët e të gjitha njësive akademike, një anëtar i zgjedhur nga stafi akademik nga çdo njësi akademike, shtatë anëtarë të zgjedhur nga Parlamenti Studentor të cilët duhet të jenë studentë

me kohë të plotë në universitet, dy anëtarë të zgjedhur nga stafi joakademik, si dhe sekretari i Përgjithshëm si anëtar i përhershëm pa të drejtë vote.

Rektori - është autoriteti kryesor menaxhues dhe përfaqësuesi ligjor e institucional i universitetit. Ai është përgjegjës për funksionimin efektiv dhe të rregullt të universitetit, si dhe për menaxhimin e tij të përgjithshëm.

Sekretari i përgjithshëm - është zyrtari më i lartë ekzekutiv dhe administrativ i Universitetit, me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të përcaktuara në kontratën e tij, e cila nënshkruhet nga rektori. Sekretari i përgjigjet rektorit për administrim efikas, ekonomik dhe efektiv në të gjitha nivelet e Universitetit. Në këtë pozitë sekretari i përgjithshëm përgjigjet për të gjitha çështjet që nuk janë kompetencë e organeve ose e udhëheqësve të tjerë. Gjithë stafi dhe studentët e Universitetit duhet të bashkëpunojnë me sekretarin e përgjithshëm të Universitetit.

Administrata Qendrore e universitetit është përgjegjëse për çështjet profesionale, administrative dhe teknike në lidhje me: Arsimin, kërkimet shkencore dhe punën artistike; Administrimin e njohjes së studimeve; Administrimin e personelit; Aspektet ligjore; Planin zhvillimor të universitetit; Kontabilitetin dhe financat. Menaxhimin e sistemit të informimit; Bazën qendrore të të dhënave; etj.

Në kuadër të Administratës Qendrore bën pjese: Zyra për Teknologji të Informacionit.

Departamenti i Teknologjisë Informative

Departamenti i Teknologjisë Informative, kryen punët profesionale dhe punët e tjera lidhur me: Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe teknologjisë informative dhe pasurisë jo fikse (Programet–Databazat) të Universitetit; Menaxhimin e infrastrukturës së teknologjisë informative në Universitet; Aplikimin e standardeve më të larta, me qëllim të zbatimit të politikave zhvillimore dhe strategjive të Universitetit – respektivisht politikave të njësive akademike; Bashkëpunimin e ngushtë me zyrtarët e administratorët e TI-së në njësi akademike; Menaxhimin e data-bazave që janë në përdorim përmes programeve përkatëse ose ndërmarrjen e aktiviteteve për menaxhimin e tyre përmes kompanive përkatëse duke zbatuar procedurat ligjore; Ndërmarrjen e iniciativave për hartimin e databazave dhe programeve të reja apo plotësimin–freskimin me module të reja të programeve ekzistuese; Hartimin e planeve strategjike të teknologjisë informative të bazuara drejtpërdrejt në Planin strategjik të Universitetit; Hartimin e specifikave për furnizime përkatëse me pajisje dhe pjesë rezervë të aparaturës përkatëse të teknologjisë informative; Servisimet dhe intervenimet profesionale në ruajtjen e funksionalitetit të aparaturës në përdorim nga zyrtarët publikë të Universitetit; Sigurimin e zgjidhjeve kualitative të teknologjisë informative për mundësimin e shkëmbimit të shpejtë, të lehtë dhe në formë të përshtatshme të informatave brenda dhe jashtë Universitetit; Krijimin e një strukture të standardizuar të TI-së, që mundëson lidhjen elektronike të departamenteve, njësive akademike, të shfrytëzuesve, partnerëve dhe ofron një rrjet të vetëm të të dhënave; Sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të TI në mënyrë të qëndrueshme, të besueshme, të sigurta dhe në përputhje me raportin ndërmjet kostos dhe përfitimeve.

Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi do të përfshijë Universitetin e Prishtinës, me fokus të veçantë në Sistemin e Menaxhimit të Studentëve (SEMS), i cili përdoret për menaxhimin e të dhënave akademike dhe administrative të studentëve. Ky sistem përfshin procese që nga regjistrimi fillestar i studentëve, menaxhimi i lëndëve dhe profesorëve, regjistrimi i notave, gjenerimi i raporteve, e deri te lëshimi i diplomave dhe dëshmive.

Auditimi do të synojë të vlerësojë nëse sistemi SEMS është zhvilluar, zbatuar dhe menaxhuar në përputhje me kërkesat ligjore, rregulloret përkatëse dhe standardet

e sigurisë së informacionit. Po ashtu, do të shqyrtohet efikasiteti i proceseve të menaxhimit të të dhënave dhe nëse janë ndërmarrë masa të mjaftueshme për mbrojtjen e të dhënave personale të studentëve dhe integritetin e informacionit akademik.

Ky auditim do të mbulojë periudhën 2022-2025 duke përfshirë gjendjen aktuale të sistemit SEMS dhe përputhshmërinë me praktikat më të mira të qeverisjes së TI-së në arsimin e lartë.

Pyetjet audituese

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjet si në vijim:

1. A ka aprovuar organizata dhe a është duke përdorur politikat dhe procedurat për të udhëzuar operacionet e biznesit dhe operacionet e TI-së?
2. Si i menaxhon organizata rreziqet e saj[31]?
3. Si i identifikon dhe aprovon organizata kërkesat e biznesit dhe të TI-së[32]?
4. A është përcaktuar dhe dokumentuar mirë pronësia e proceseve të biznesit[33]?
5. A është e mjaftueshme marrëveshja e detajuar për të identifikuar të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë në mes të organizatës dhe ofruesit të shërbimit?
6. A sigurohet vazhdimësia e biznesit nëse OE nuk ka mundësi të ofrojë në një pikë në të ardhmen këto shërbime[34]?

31 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Qeverisja e TI-se, Menaxhimi i rrezikut.
32 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Qeverisja e TI-se, Përcaktimi i kërkesave të TI-së.
33 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontraktimi, Mbajtja e njohurive të biznesit / Pronësia e proceseve të biznesit .
34 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Kontraktimi.

7. A ekziston mekanizëm që siguron se kërkesat e sigurisë janë adresuar nga ofruesi i shërbimit[35]?
8. A posedon organizata plan dhe procedura të qëndrueshme për vazhdimësinë e biznesit?
9. A sigurojnë kontrollet e aplikacionit integritetin dhe plotësinë e transaksioneve të tij[36]?

Kriteret e auditimit[37]

Kriteret e përdorura në këtë auditim rrjedhin nga Manuali Aktiv i Auditimit të TI-së[38].

- Organizata dokumenton, aprovon dhe komunikon politikat dhe procedurat e duhura për të udhëzuar operacionet e biznesit dhe të TI-së, me qëllim të arritjes të mandatit të saj.
- Organizata duhet të ketë politika dhe plane të menaxhimit të rrezikut, si dhe ka përcaktuar burimet e mjaftueshme për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet.
- Organizata duhet të ketë një plan sesi të identifikojë kërkesat e reja të biznesit ose nevojat e TI-së dhe Komiteti Drejtues, i cili aprovon kërkesat, ka informacion të mjaftueshëm për vendimarrje.
- Organizata duhet të ketë të dokumentuar pronësisë e proceseve të biznesit.
- Organizatat mbajnë njohuritë e biznesit dhe janë në gjendje të vazhdojnë operacionet brenda funksionit kritik nëse kontraktorët ose shitësit nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbimin.
- Marrëveshja në nivel shërbimi është baza për monitorimin dhe kontrollin e kontraktorit ose furnitorit kundrejt specifikimeve teknike.

35 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontraktimi, Siguria.
36 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e përpunimit
37 Për më shumë informata konsultoni ISSAI 300, Criteria, p.7
38 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është produkt i grupeve të punës së teknologjisë së informacionit të EUROSAI-t (WGITA) si dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI) për përcaktimin e rregullave e standardeve të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.- më tej Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

- Kërkesat e sigurisë së organizatës janë theksuar nga kontraktori në mënyrë të përshtatshme.
- Politikat organizative mbi vazhdimësinë e biznesit, të cilat përmbajnë detyrat dhe përgjegjësitë, qëllimin, kriteret e alokimit të burimeve/parimet, kërkesat për trajnim, orar të mirëmbajtjes, orarin e testimeve, planet backup, si dhe nivele e aprovimit.
- Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në përputhje me sjelljen e pritur.

  Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në mënyrë të kontrolluar dhe të besueshme, duke siguruar që ato të përputhen me rregullat e biznesit, parametrat e konfigurimit dhe skenarët e parashikuar të përpunimit[39].

Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit do të zbatojmë metodologjinë në vijim:

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit do të zbatojmë metodologjinë në vijim:

Gjatë këtij auditimi do të përdoren një shumëllojshmëri teknikash për të siguruar dëshmi të besueshme dhe për të vlerësuar funksionimin efektiv të sistemit SEMS. Auditimi do të përfshijë:

- Analizimin e kornizës ligjore dhe rregullative që rregullon funksionimin e SEMS dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- Shqyrtimin e politikave dhe procedurave të brendshme të Universitetit të Prishtinës që lidhen me zhvillimin, ndryshimin dhe menaxhimin e sistemeve të TI-së;
- Rishikimin e strukturës organizative dhe roleve përgjegjëse për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit SEMS;

39 Përdorimi i udhëzimeve të COBIT (sidomos DSS05 dhe BAI09) për kontrollin e proceseve dhe sigurimin e besueshmërisë së përpunimit të transaksioneve.

- Analizimin e moduleve dhe funksionaliteteve kryesore të SEMS, duke përfshirë regjistrimin e studentëve, menaxhimin e provimeve, notave, raportet dhe integrimet me sistemet e tjera;
- Intervista me personelin përgjegjës për administrimin e sistemit dhe përfaqësues të njësive akademike që e përdorin sistemin;
- Shqyrtimin e raporteve të punës, regjistrave të incidenteve dhe veprimeve të ndërmarra në rastet e gabimeve teknike apo ndërprerjeve të sistemit;
- Analizimin e mekanizmave të sigurisë, përfshirë autentifikimin, backup-et, dhe mbrojtjen e të dhënave në rrjet;
- Vlerësimin e marrëdhënieve kontraktuale me palët e jashtme që ofrojnë mirëmbajtje, zhvillim ose shërbime teknike për SEMS.

Dokumentet relevante

Statuti i Universitetit të Prishtinës (UP) "HASAN PRISHTINA"

Ligji nr. 04/l-037 për arsimin e lartë në republikën e Kosovës

Strategjia e Arsimit 2022-2026

Plani strategjik 2023-2025

Rregullorja Nr. Prot. 2-529 për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin, Klasifikimin dhe Përshkrimin e Pozitave të Punës në UP

Rregullorja e punës së SEMS-i

Shtojca II. Letër konfirmimi

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISHTINA
Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-p.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/861
Datë: 9 / 6 / 2026

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit **Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve,** dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve** (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Rektori
Prof. Arben Hajrullahu

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës